VENDIM
Nr. 851, datë 29.12.2021

PËR MIRATIMIN E TRANSFERTËS KAPITALE NË LLOGARI TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

(ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 403, datë 5.7.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, i parashikuar për ndërhyrjen dhe përmirësimin e konektivitetit dhe rrugëve të aksesit, në kuadër të programit buxhetor të 100 fshatrave, kalohet nga zëri "Investime" (231) në zërin "Transfertë kapitale" (232), për llogari të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (SHZH), për blerje makinerish, si pjesëmarrje në kapitalin e operatorit për mirëmbajtjen dhe hapjen e rrugëve rurale dhe turistike, në bashkëpunim me njësitë vendore.

2. Fondi prej 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekësh, i parashikuar në "Programe zhvillimi", përkatësisht 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë, kapitulli 04 zëri "TVSH", dhe 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, kapitulli 03 "Financimi i kostos së bashkëfinancimit të projekteve, që zbatohen nga FSHZH", kalon si transfertë kapitale (232) për llogari të FSHZH-së për zhvillimin e modelit të integruar në formën e një parku multifunksional me temën e 100 fshatrave në Valias, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

3. Fondi kapital, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, kalohet në "Mjete në Ruajtje".

3/1. Për të kryer veprime transferimi me fondin "Mjete në ruajtje" veprohet, si më poshtë vijon:

a) Destinacioni i përdorimit të fondeve, të përcaktuar në pikën 3, që janë "Mjete në ruajtje", është për financimin e dy projekteve, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, konkretisht:

- Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, i parashikuar për "Ndërhyrjen dhe përmirësimin e konektivitetit dhe rrugëve të aksesit", në kuadër të programit buxhetor të 100 Fshatrave, për blerje makinerish që do të jenë pjesëmarrje në kapitalin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për mirëmbajtjen dhe hapjen e rrugëve rurale dhe turistike, në bashkëpunim me njësitë vendore;

- Fondi prej 600 000 000 (gjatëqind milionë) lekësh, i parashikuar për zhvillimin e modelit të integruar në formën e një parku multifunksional me temën e 100 Fshatrave në Valias në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

b) Fondet e përcaktuara në këtë vendim transferohen në llogarinë bankare të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

c) Transferimi i fondeve, nga "mjete në ruajtje" në llogarinë bankare të përcaktuar në shkronjën "b" më sipër, kryhet në përputhje me vlerën e kontratës së nënshkruar për secilin projekt.

ç) Diferenca e fondeve të papërdorura kthehet në buxhetin e shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama